



Viti i VI-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2015

ETIKA ADMINISTRATIVE

Hazize Jonuzi*, Ali Pajaziti*

*Universiteti i Europës Juglindore,

Adresë kontakti: hazizejonuzi@hotmail.com

Përmbledhje

Ky artikull trajton një temë shumë të rëndësishme për epokën tonë krizologjike në fillim të mileniumit të tretë, etikën dhe moralin, si segment shumë relevant si për jetën shoqërore në përgjithësi ashtu edhe për shërbimin publik.

Punimi fokusohet mbi etikën administrative, mbi diskursin etik të shërbyesve të cilët janë të detyruar të veprojnë përmes pozitave publike në emër të interesit publik. Ai i trajton çështjet më kyçe të lidhura me etikën administrative, si: etikën, moralin, lidhjen në mes etikës dhe administratës, administratën publike dhe nëpunësit publik.

Në këtë punim është shfrytëzuar një literaturë relevante e Etikës dhe Administratës (Publike dhe Shtetërore), nga e cila kuptohet se çfarë është etika, administrata, nëpunësit dhe ndërlidhje e të tre termeve në një, duke lënë të kuptohet rëndësia e Etikës Administrative, si fushë jo shumë e trajtuar në Evropën Juglindore.

Fjalë çelës: *Morali, etika, administrata publike, etika dhe administrata, nëpunësi shtetëror.*

THE ADMINISTRATIVE ETHICS

Abstract

This article discusses a very important topic for our crisiological time in the beginning of the third millennium, ethics and morality, as relevant segment as for society in general and for public service.

The paper focuses on administrative ethics, the ethical discourse of servants who are required to act through public positions on behalf of the public interest. It addresses key issues related to administrative ethics, as ethics, morality, ethics and the relationship between administration, public administration and public officials.

In this paper was used a relevant literature of Ethics and Administration (state and public), by which is understood what is ethics, administration, employees and correlation of these three terms in one, implying the importance of Administrative Ethics, a field not much treated in the Southeast Europe

Key Words: *Morality, Ethics, Public Administration, Ethics and Administration, State Officials/ Public Servants.*

I. Etika Administrative

Çfarë është Morali?

Morali është koncept i të mirës dhe të keqes, të drejtës dhe të gabuarës, virtutit dhe vesit, drejtësisë. Morali është grumbull i traditave, në veçanti traditave të mira, ato që mundësojnë mbijetesë të volitshme dhe të thjeshtë, si dhe zhvillim të individit dhe shoqërisë, virtyte, qëndrueshmëri. Ligji më i lartë për mbajtjen e shoqërive njerëzore është ide, qëllimi i së cilës është që të këshillojë dikë për moralin.

Morali paraqitet si tërësi e parimeve, e normave dhe e rregullave që përcaktojnë sjelljen e njeriut në shoqëri; që lidhet me nderin me sjelljen e ndershme a të pandershme të dikujt. Fjala moral rrjedh nga latinishtja *mos* që d.m.th zakon, doke, shprehi dhe morali që u përket zakoneve, dokeve e shprehive. Një kuptim tjetër për moralin është se ai është:

- tërësia e parimeve, e normave dhe e rregullave sipas të cilave sillen njerëzit në shoqëri, vetë sjellja e njerëzve sipas këtyre parimeve, rregullave dhe normave;

- nder, sjellje e ndershme, ndershmëri;

- vetëbesim, trimëri; tërësi e forcave të brendshme që e shtojnë njeriu të veprorë, të qëndrojnë a të plotësojnë një detyrë, gjendja e brendshme shpirtërore e dikujt.

Morali është një *“sistem rregullash që duhen respektuar nga individit për tu ndihmuar në dallimin e së keqes nga e mira, në dallimin e detyrimeve”*.

Me moralin lidhet njeriu i moralshëm, ku i moralshëm është ai që ka të bëjë me moralin dhe rregullat e tij, zakon i brendshëm, sipas së cilit askush nuk duhet që të bëjë atë që atij s’do të kishte dashur që t’i bëhet. Morali lidhet edhe me nocionin moralitet që rrjedh nga latinishtja *moralitas* e që do të thotë ata që janë në përputhje me kërkesat morale, vetitë e përshtatshme me ligjet më të larta, mirëmbajtjen e shoqërisë njerëzore, tërësia e gjinisë njerëzore (supr. Legaliteti, Vetë në përputhje me ligjet dhe sistemin juridik të një shteti)... Sipas Rawls moraliteti përkufizohet si *“instrument i drejtësisë sociale”* që është në themele të strukturës së shoqërisë, që jeton përmes mënyrës se si institucionet sociale shpërndajnë të drejtat themelore, përgjegjësitë dhe avantazhet sociale.

Çdo shoqëri ka pasur sistemin e vet të sjelljes (moralit), ku i njëjti ndryshon nga shoqëria në shoqëri dhe brenda një shoqërie në kohë të ndryshme.

Morali përbëhet nga detyrat që njeriu ka ndaj pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë. Si rregulla shoqërore – rregullat morale nuk janë të shkruara, por ata janë ngushtë të ndërlidhura me rregullat juridike. Kjo është kështu sepse rregullat juridike sillen sipas parimeve themelore morale shoqërore dhe ndërgjegjes së shoqërisë. Në të kundërtën, nëse e drejta juridike nuk përputhet me rregullat morale shoqërore atëherë nuk ka jetë të gjatë kjo e drejtë. Shembull i lidhjes së këtyre rregullave ekziston në disa fusha, si: vrasja, vjedhja, falsifikimi, që janë vepra penale (të ndaluara) dhe sanksionohen me ligj, po ashtu ato janë për shoqërinë të “shëmtuara”. Rregullat morale nuk janë të shkruara dhe shkeljet e tyre sanksionohen nga individë, nga të cilët edhe sillen. Ndërsa rregullat juridike sillen nga organet ligjvënëse të shtetit dhe shkeljet e tyre sanksionohen nga organe tjera kompetente shtetërore.

Sa i përket sjelljes morale, ajo fillon me frymën e familjes, **“nga prindërit”** u përcillen normat morale fëmijëve, gjatë procesit të rritjes (përgatitjes) dhe atëherë u tregohet atyre se çka duhet bërë ose çka nuk duhet bërë. Kjo gjë më pastaj përcillet në shoqëri.

Disa çështje që duhen ditur, janë se morali është degë të cilën e studion etika si shkencë më e gjerë dhe më e thellë. Dallimi në mes të etikës dhe moralit është se etika është disiplinë e cila merret me studimin e çështjeve të moralit, gjegjësisht ajo i studion format e ndryshme që i marrin rregullat e sjelljes të individit. Etika është filozofia e moralit. Etika është filozofia e moralit, që d.m.th ajo u shkon më thellë studimit të normave morale. Ajo ka të bëjë edhe me teorinë edhe me përmbajtjen e moralit, ndërsa morali ka të bëjë vetëm me përmbajtjen e tij dhe jo me teorinë e moralit.

2. Etika

“Njerëzit do të bënin natyrisht se çka është e mire nëse dinin se çka është e drejtë. Veprimet e këqija dhe të pahijshme janë si rezultat i injorancës”.

Sokrati

“Etika është shkencë mbi moralin ose etnosin”. Etika është shkencë që studion moralin, karakterin klasor e historik të tij, normat e sjelljes së njerëzve si një nga format e ndërgjegjes shoqërore, detyrat e tyre kundrejt njeri-tjetrit, kundrejt shoqërisë, atdheut etj. Etika është tërësia e normave të sjelljes, të moralit.

Në kohën bashkëkohore është shumë e rëndësishme por edhe më e vështirë çështja e etikës së njeriut. Kjo çështje është me njeriun kudo që ai të kthehet. Etika është me të në çdo hap të jetës së tij, në çdo lëvizje, në çdo shprehje, në çdo vepër, qoftë ajo e mirë apo e keqe. Është e rëndësishme për kohën në të cilën ne jetojmë, për brezat që janë dhe vijnë në shoqërinë tonë, për njerëzit që njohin vetëm vlera të njehsueshme dhe materiale, për ata njerëz që spiritus movens e kanë interesin, dobinë dhe asgjë tjetër.

Këtu është esenca e saj, se etika si shkencë orvatet që të marrë e të hulumtojë normat morale të njerëzve, si individë dhe si grupe shoqërore, normat e sjelljes së njerëzve që janë të shumta dhe të rëndësishme për shoqërinë, sjelljen e tyre ndaj njeri – tjetrit si një detyrë shoqërore dhe sjelljet e tyre ndaj institucioneve të shtetit dhe atyre që punojnë në to. Etika paraqet një grumbull të rregullash të sjelljes së individëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Etika barazohet me moralin, e që është normë e sjelljes së mirë ose të keqe të një individi.

Sipas Enciklopedisë Britanike (*Encyclopedia Britanica*) etika është degë e filozofisë që merret me vlerat themelore të marrëdhënieve ndërnjerëzore që e studion cilësinë dhe bazën e veprave ose sjelljeve, të cilat nga këndi i moralit janë të mira ose të këqija, të qëlluara ose të shëmtuara.

Merriam Webster’s Collegiate Dictionary e shpjegon etikën si një disiplinë që ka të bëjë me të mirën dhe të keqen, si dhe me detyrimet morale si një tërësi e parimeve dhe vlerave morale, si sistem të vlerave morale, si parime të sjelljes që i qeverisin një individ ose grup, si filozofi drejtuese (*guiding philosophy*).

3. Etika dhe administrata

Administrata është *“një institucion legjitim dhe i rëndësishëm brenda një rendi kushtetues”.* Etika paraqet *“tërësi normash të sjelljes publike dhe private, që kërkohet të ndiqet nga një person ose nga një komunitet personash”*, në sferën publike dhe atë private, ku si tipare kryesore të saj paraqiten: përgjegjësia, toleranca, nderi, respekti, besnikëria, korrektesia, të qenët i ekuilibruar, i barabartë, i drejtë, i thjeshtë. Ndërsa fjala administratë vjen nga latinishtja Administrata (*lat. Administration*) drejtim, administratë, qeveri drejtuese, qeveri, shërbyese, shërbim. Kjo na tregon se aktivitetet në një vend drejtohen, qeverisen nga një qeveri drejtuese e cila e ka për obligim që të kryejë shërbime ndaj masës së gjerë popullore.

Shteti për të përmbushur detyrat e tij ndaj qytetarëve dhe ndaj vetvetes, organizohet nëpër grupe më të vogla profesionale të ashtuquajtura administrata. Administratat shtetërore dhe ato publike kanë për detyrë që t’i shërbejnë vetë shtetit, qytetarëve, të zhvillojnë parime të demokracisë, sundimit të së drejtës, garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të ndihmojnë në zhvillimin dhe stimulimin e vetëqeverisjes lokale përmes parimeve dhe normave që promovojnë vlerat e përgjithshme morale të cilat janë në dobi të shoqërisë.

Pra, etika e cila merret me studimin e sjelljeve të ndryshme të nëpunësve dhe njerëzve është e ndërlidhur ngushtë me institucionet shtetërore dhe publike, pasi që me vetë sjelljen e nëpunësve ndaj qytetarëve paraqitet një pasqyrë e përgjegjësisë, nderit, lojaliteti, besimit, sigurisë, dashamirësisë, integritetit të tyre në shoqëri. Është e domosdoshme që të ekzistojë etikë e nëpunësve nëpër institucionet e sferave të ndryshme

dhe niveleve të ndryshme administrative, pasi që nëse nuk ekzistojnë rregulla të sjelljes nëpër administrata dhe ndaj qytetarëve atëherë shfaqet një kaos si në vetë administratë ashtu edhe në shoqërinë e gjerë.

Siç dihet, shteti ka për detyrë të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe qytetarëve. Veprimtaria shtetërore e bazuar në norma dhe në standarde të etikës administrative do të rregullonte dhe balanconte marrëdhëniet ndërmjet administratës dhe qytetarëve, duke i kushtuar rëndësi të veçantë interesit publik dhe shtetëror. E gjithë kjo arrihet duke formuar një staf administrativ të administratës publike ose të asaj shtetërore të bazuar në standarde të sjelljes dhe moralit.

Administrata shtetërore dhe ajo publike, mes tjerash, kanë për qëllim kryesor që të rrisin kriteret etike të nëpunësve të tyre për shërbimet që ata i ofrojnë ndaj publikut dhe që tek të njëjtët të ngjallin dhe ta kultivojnë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj veprimtarisë profesionale. Në këtë mënyrë administrata synon ngritjen e normave, standardeve, vlerave dhe idealeve etike në kryerjen e veprimtarive të nëpunësve shtetërorë dhe publik.

Administrata ka dy vlera që e bëjnë atë të jetë etike:

- Dashamirësia dhe
- Virtyti i mirësisë.

- Dashamirësia- *“Shpirti i një administrate publike është i varur nga morali i një dashamirësie ndaj të gjithë qytetarëve”*. Puna e administratës publike pa dashamirësi nuk është punë e zbatuar për qytetarët, ndërsa me dashamirësi ajo është një punë për çmim Nobel, pasi qytetarët e meritojnë një veti të tillë të administratorëve publik. Administrata publike është më e gjerë se administrata shtetërore, pasi që ka nën kujdesin e saj aktivitete të gjëra shoqërore, të cilat bazohen në korniza ligjore. Kjo është një trajtë më e gjerë e kujdesit ndaj shoqërisë. Për atë shkak edhe duhet që të jetë etike në sjelljen ndaj qytetarëve, që të plotësojë në nivel sa më të lartë nevojat dhe të drejtat e tyre.

- Virtyti i mirësisë- *“Kush privohet nga butësia është privuar nga e mira”*. Administrata publike është e obliguar që të kujdeset për të gjithë qytetarët, duke mos bërë kurrfarë dallimi mes tyre. Ajo është e obliguar që të propozojë dhe japë rekomandime ndaj vendimmarrësve dhe vendimet e njëjta t’i implementojë në shoqëri. Administratorët publikë duhet që në të dy rastet: edhe në dhënien e rekomandimeve edhe në rastin e implementimit të politikave publike të jenë të paanshëm në çështjet partiake, duke çuar përpara interesin publik dhe duke e lënë anësh interesin personal. Këta administratorë duhet që të kujdesen për interesin e gjerë publik, pasi që një ditë mund që të mos jenë në zbatim zyrtarë të vendimeve dhe politikave publike, kështu që ajo do të jetë më vonë në interes të tyre. Administratori publik duhet që të kenë një shpirt administrativ i cili përmban *“rritjen e shpresës për ndryshime pozitive, përgjegjësinë publike dhe pjesëmarrjen e qytetarëve që nxit dashamirësinë për të gjithë”*.

Administrata publike

Administrata Publike sipas pikëpamjes politike, është ajo që qeveria e bën, direkt ose indirekt për interesin publik dhe përmes ciklit të politikë-bërjes. Ajo zhvillohet sipas disa aspekteve dhe modeleve: modelit tradicional dhe modelit bashkëkohor. Administrata Publike sipas modelit tradicional bën kontrollin formal të liderizmit politik, e bazuar rreptësisht mbi modelin hierarkik të burokracisë, e ekipuar vetëm nga interesi publik, të cilët në mënyrë të njëjtë i shërbejnë cilëso partie në pushtet dhe të cilët nuk kontribuojnë në politikat e zbatuara, por vetëm i zbatojnë politikat e miratuara nga politikanët. Për sa i përket modelit bashkëkohorë ai zhvillohet mbi konceptin e Weber-it, për një Administratë Publike profesionale dhe që promovon interesat dhe nivelin e lartë të moralit. Në këtë mënyrë promovohet një Administratë neutrale publike e bazuar në meritë dhe jo e varur nga politika.

Sipas Maks Weber-it, kriteret e një Administrate Publike bashkëkohore mund të jenë:

- struktura personale në pushtet

- hierarkia e shërbimeve dhe sistemi i karrierës për sfera konkrete të përgjegjëse
- selektimi i lirë në bazë të rezultateve të arritura në përputhje me rregullat e përcaktuara
- disiplina dhe kontrolli në sjelljen e shërbyesve (nëpunësve).

Një shtet që të mund të funksionojë në mënyrë sa më efikase, të zbatojë ligjet dhe të plotësojë nevojat, të drejtat dhe obligimet e qytetarëve, duhet që të kontribuojë dhe të përmbahet në *“parimet e ligjshmërisë, të besueshmërisë, parashikimit, përgjegjshmërisë dhe transparencës, si dhe kompetencat teknike dhe drejtuese, kapacitetet organizative dhe pjesëmarrjen qytetare”*. E gjithë kjo është e ndërlidhur ngushtë me funksionimin e Administratës Publike të shtetit, në kuadrin e të cilës gjendet edhe Administrata Shtetërore si bartëse e pushtetit shtetëror, garantimit, sigurimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të po atij shteti.

Nëpunësit publikë

Me termin nëpunës nënkuptojmë *“mbajtës të fuqive të shtetit”*, ku si të tillë duhet që të kujdesen për sigurinë e zbatimit të drejtë të ligjit, parimeve administrative dhe kushtetuese në administratat publike.

“Nëpunësit civilë shihen si armët ekzekutive të shtetit, të aftë për të shërbyer cilëndo qeveri në fuqi (parimi i neutralitetit politik), dhe të përgjegjshëm para ligjit për funksionet e tyre” që nuk do të thotë që të jesh përkrahës i një partie politike dhe të jesh në administratën publike dhe në shërbimin publik përderisa është ajo në pushtet, dhe me daljen e saj edhe ti të dalësh, të largohesh nga vendi i punës, por do të thotë që nëpunësit publikë i qëndrojnë besnikë qeverisë që vjen në pushtet pa marrë parasysh përkrahjen e tyre politike, dhe po të njëjtit duhet që të vazhdojnë nëpër vendet e tyre të punës dhe të avancojnë administratën publike dhe shërbimet e saj ndaj qytetarëve. Është kështu, pasi qytetarët janë ata që meritojnë që shteti i tyre t’i mbrojë dhe sigurojë në të drejtat që ata edhe u janë të garantuara me kushtetutë dhe me ligje.

Shërbimet e ndryshme që u ofrohen qytetarëve, interesat e ndryshëm që ata vetë i realizojnë dhe shumë fenomene të tjera që janë të lidhura ngushtë ndërmjet shtetit si një organizatë e gjerë territoriale dhe sistem i sigurimit dhe mbrojtjes së interesit të gjerë publik, nga njëra anë dhe qytetarëve të po atij shteti si kërkues dhe realizues të interesave dhe të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë dhe me ligje të posaçme, nga ana tjetër, realizohen përmes të ashtuquajturve nëpunës shtetërorë dhe shërbyes publikë.

Këta të punësuar janë të autorizuar me ligje të veçanta që të jenë çdoherë në shërbim të qytetarëve dhe në çdo kohë të mbrojnë interesat e gjëra publike. Ata janë të autorizuar me kompetencat e tyre në vendet e tyre të veçanta të punës. Ata kanë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre profesionale ndaj të cilave duhet që të jenë çdoherë të kujdesshëm dhe t’i zbatojnë në kohë dhe ndaj personave të duhur.

Veprimtaria e këtyre nëpunësve është e rregulluar me ligje të posaçme të cilat e rregullojnë mënyrën e tyre të sjelljes ndërmjet vetë grupeve profesionale të nëpunësve dhe ndërmjet tyre dhe opinionit publik, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në punë. Këto janë norma ligjore ose janë norma të cilat me kalimin e kohës kalojnë në standarde të sjelljes, të cilat vetë grupet profesionale i përcaktojnë si të tilla, pasi që bëhen tanimë praktikë e punës dhe marrëdhëniet me qytetarët.

Çdo nëpunës, si një individ i vetëm ka sjelljet e tij në kryerjen e detyrave të tij profesionale. Kjo sjellje pasqyron moralin e tij, si një kriter që merret parasysh në marrëdhëniet e tij me qytetarët, me kolegët e tij të punës ose edhe në realizimin e detyrave të tij të punës.

Sa i përket nëpunësit publik mund të thuhet se shteti duhet të garantojë një cilësi të caktuar të stafit të tij dhe standarde të kualitetit të barabartë në të gjitha sferat e administratës publike. Kushtet që duhet t’i plotësojnë nëpunësit janë të lidhura me: të drejtat dhe detyrimet, qëndrueshmërinë profesionale, mbrojtjen nga cenimet politike dhe nga ndërhyrja e lobeve, nivele të përshtatshme pagese në mënyrë që të reduktohet mundësia e korrupsionit, masa disiplinore dhe përzgjedhje bazuar në meritë.

Është më se e qartë se administrata publike i kryen detyrat e saj përmes stafit të saj profesional, përmes shërbyesve civilë, detyrat dhe të drejtat e të cilëve janë të rregulluara me Ligjin e punës dhe Ligjin e nëpunësve shtetërorë. Mirëpo në analizat e bëra rreth funksionimit të tyre shihet se *“nëpunësit civilë nuk janë vetëm punonjës të shtetit, por kanë gjithashtu një rol kushtetues. Prandaj është e papërshtatshme të rregullohen marrëdhëniet e shtetit ose të një institucioni shtetëror dhe nëpunësve të vetë civilë vetëm nga kodi i punës”*.

Për të qenë të kujdesshëm dhe profesionalë në punën e tyre nëpunësit publikë duhet që të kenë parasysh qëllimet e tyre gjatë zbatimit të kompetencave të tyre, si: krijimi i mekanizmave të kontrollit dhe përgjegjshmërisë për të shmangur abuzimin e fuqive publike dhe keqmenaxhimin e burimeve publike; dhënia legjitimitet administratës publike në sytë e qytetarëve dhe taksa-paguesve për të ndërtuar besim në administratë dhe tek shteti në tërësi; dallimi ndërmjet sferës publike e politikave nga një sferë publike e administratës (për shkak të natyrës së tyre të ndryshme të legjitimitetit); vazhdimësia profesionale në administratën publike dhe nxitja e një modeli të caktuar sjelljeje në të gjitha pjesët e administratës; tërheqja e kandidatëve më të mirë ekzistues në vend për shërbimin civil dhe mbajtja e tyre nëpërmjet prospektit të arsyeshëm të zhvillimit të karrierës dhe vetë-kënaqësisë personale.

Nga e gjithë kjo mund të përfundojmë se Etika dhe Administrata kanë një ndërlidhje tepër të ngushtë dhe të pandashme. Është kështu, pasi që një administratë publike (shtetërore) është drejtuese, ose, thjesht thënë, qeverisëse e një shteti, e detyrave të tij dhe ligjeve të tij. Ajo qeveris përmes të punësuarve të saj, të ashtuquajtur nëpunës publikë ose shtetërorë, të cilët janë të zgjedhur nga populli ose janë të punësuar përmes të njëjtave procedurave të posaçme ligjore. Pikërisht këta persona, të cilët kanë barrën më të madhe publike: zbatimin e ligjeve, dhënie e shërbimeve ndaj qytetarëve, prurjen e vendimeve të rëndësishme shtetërore dhe publike, mbrojtjen e interesit të gjerë publik, promovimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe sërë punësh zyrtare në kompetencë të tyre publike, nuk mund të veprojnë nëse nuk kanë në konsideratë sjelljen e tyre në punë. Sjellja e tyre ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj qytetarëve, qëndrimi dhe fushëveprimi i tyre mbi baza të kompetencave të tyre zyrtare i paraprin një Etike Administrative të një Administrate Publike efikase dhe të moralshme. Nëpunësit publikë, në çdo hap, në çdo shprehje, në çdo mendim dhe bindje të tyre, duhet të kenë parasysh vlerat etike: besnikërinë, besueshmërinë, korrektësinë, drejtësinë, nderin, sjelljen e mirë, përgjegjësinë, tolerancën dhe vlerat tjera mbi të cilat ndërtohet një administratë Publike (shtetërore) efikase dhe e pa cenushme dhe në të njëjtën kohë e hapur dhe e besueshme për qytetarët e saj. Se sa një administratë publike dhe administratorët e saj sillen në mënyrë efikase dhe etike, mund ta tregojnë të dhënat që do të merren nga hulumtimet shkencore.

Referenca

1. http://en.wikipedia.org/wiki/Ethics#Modern_ethics, mars, 2011
2. Ali Pajaziti, "Etika dhe Administrata Publike: Rasti RM", në *Shteti i së Drejtës dhe Reformat në Administratën Publike*, UEJL, Tetovë, 2008, f. 95.
3. Ali Pajaziti (ed.), *Etika Publike*, Logos-A, Prishtinë, 2005, f. 13.
4. Ali Pajaziti, "Etika dhe administrata publike: Rasti RM", f. 13.
5. Ali Pajaziti, "Etika dhe Administrata Publike: Rasti RM", f. 95-96.
6. Ali Pajaziti, "Etika dhe administrata publike: Rasti RM", f. 95.
7. Ali Pajaziti, "Etika dhe administrata publike: Rasti RM", f. 95.
8. http://polsci.ku.dk/english/public_value_workshop/bilag/overeem.pdf, Patrick Overeem, *Public Values and Public Interest*.
9. Ndiçim Kulla & Dritan Thomollari, *Etika dhe iluminimi-skicë për një manifest të jetës intelektuale*, Tiranë, 2005, f. 25.
10. George H. Frederickson, *The Spirit of Public Administration*, Jossey-Bass Inc., San Francisco, 1997, f. 16.
11. Muhammed Xhenberi, *Morali ynë*, Fakulteti i Shkencave të fesë, Universiteti i Azharit, Kajro, Tetovë, 2006, f. 54.
12. George H. Frederickson, *The Spirit of Public Administration*, Jossey-Bass Inc., San Francisco, 1997, f. 17.
13. http://www.sigmaweb.org/searchResult/0,3400,en_33638100_34612958_1_1_1_1_1,00.html/ Parime Evropiane për Administratën Publike, Botimi SIGMA nr 27, prill, 2011, f. 7
14. http://www.sigmaweb.org/searchResult/0,3400,en_33638100_34612958_1_1_1_1_1,00.html/ Parime Evropiane për Administratën Publike, Botimi SIGMA nr 27, prill, 2011, f. 8
15. http://www.sigmaweb.org/searchResult/0,3400,en_33638100_34612958_1_1_1_1_1,00.html/ Parime Evropiane për Administratën Publike, Botimi SIGMA nr 27, prill, 2011, f. 11-13